



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

24.03.2021

Zbatimi i modeleve të duhura të organizimit dhe drejtimit, kontrolli i brendshëm i njësive ekonomike të biznesit dhe përdorimi i sistemeve të informacionit dhe informatikës

TEZA 2

ALTERNATIVA (10 x 1 pikë)

1. Matrica Mendelow jep lidhjen mes:

- a. Interesit dhe influencës;
- b. Interesit dhe fuqisë;
- c. Influencës dhe fuqisë;
- d. a,b,c
- e. Interesit dhe pushtetit
- f. Influences dhe pushtetit
- g. Pushtetit dhe fuqise
- h. Asnjë nga alternativat

Përgjigja e saktë është alternativa B

2. Në kujtesën RAM:

- a. Vetëm mund të lexohet
- b. Vetëm mund të shkruhet
- c. mund të shkruhet dhe të lexohet
- d. Asnjëra prej tyre
- e. Nuk mund të shkruhet
- f. Nuk mund të lexohet
- g. Të gjitha bashkë
- h. Mund të printohet dhe editohet

Përgjigja e saktë është alternativa C

3. Sistemi i manaxhimit të bazave të të dhënave (DBMS) relacionare kuptohet nga lidhja e dy koncepteve si më poshtë:

- a. E dhënë – Informacion
- b. Rekord – Atribut

- c. Entiti – Relacion
- d. Asnjëra prej tyre
- e. Të gjitha bashkë
- f. Rekord-Relacion
- g. E dhënë-Relacion
- h. Entiti-Rekord

Përgjigja e saktë është alternativa C

4. Cila prej alternativave të mëposhtme është e sakte?

- a. Monitorimi i kontrolleve është procesi që vlerëson sasinë e kontrolleve të brendshme gjatë periudhës
- b. Monitorimi i kontrolleve është procesi që vlerëson shpeshtësinë e kontrolleve të brendshme gjatë periudhës
- c. Monitorimi i kontrolleve është procesi që vlerëson auditmin e brendshëm gjatë periudhës
- d. Monitorimi i kontrolleve është procesi që udhëzon Drejtimin e njësisë ekonomike se si të zbatohet direktivat që ka vendosur Bordi i Drejtuesve
- e. Monitorimi i kontrolleve është procesi që u jep siguri të majftueshme aksionareve të njësisë ekonomike se ambjenti i kontrollit është i shëndetshëm
- f. Monitorimi i kontrolleve është procesi që vlerëson cilësinë e performancës së kontrolleve të brendshme gjatë periudhës.
- g. Të gjitha me lart
- h. Asnjë nga të mësipërmet

Përgjigja e saktë është alternativa F

5. Nje prej faktorëve që ndikon në ambjentin e kontrollit është edhe Vendorsja e Autoritetit dhe Pergjegjesise. Cilet prej elementeve të mëposhtëm, përfshihen në Vendorsjen e autoritetit dhe përgjegjësisë:

- a. Politika në lidhje me praktikën e pranuar të biznesit
- b. Njohurinë dhe experiencën e punonjësve
- c. Burimet e nevojshme për realizimin e detyrave të caktuara
- d. Politikën dhe komunikimin drejtuar personelit mbi kuptueshmërinë e objektivave
- e. Politikën dhe komunikimin drejtuar personelit mbi kuptueshmërinë e objektivave ndërveprimet dhe kontributin e veprimve të tyre ndaj këtyre objektivave
- f. Politikën dhe komunikimin drejtuar personelit mbi vlerësimin se mbi çfarë dhe mbi kë duhet të mbajnë përgjegjësi
- g. Të gjitha me lart
- h. Asnjë nga të mësipërmet

Përgjigja e saktë është alternativa G

6. Sipas SNA 315, si pjesë e njohjes së entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë këtu dhe kontrollin e brendshëm, një auditues duhet të njohë të gjitha më poshtë, përveç:

- a. Sektorin e ekonomisë ku entiteti vepron;
- b. Natyrën e entitetit, përfshirë mënyrën sesi entiteti është strukturuar dhe financohet;
- c. Natyrën e entitetit, përfshirë strukturat e tij të drejtimit dhe qeverisjes;
- d. Kultura e sjelljes etike vendosur nga strukturat e drejtimit dhe qeverisjes;
- e. Politikat kontabël që një entitet ka zgjedhur dhe zbatuar;
- f. Matjen dhe risihikimin e performancës financiare të entitetit;
- g. Natyrën e entitetit, përfshirë investimet për qëllime të veçanta;
- h. Objektivat dhe strategjitë e entitetit.

Përgjigja e saktë është alternativa D

7. Nje kompani e cila ka nje sistem te automatizuar per kontrollin e kostove, ka ne fillim te muajit mars nje gjendje te prodhimit ne proces prej 300 njesish per nje produkt te sajine. Kosto e ketij produkti ne proces eshte vleresuar 1,710 EUR dhe perben rreth 60% te totalit te koston se prodhimit. Gjate muajit mars jane perfunduar dhe transferuar ne magazine e produkteve te gatshme, 2,000 njesi nga ky produkt. Kosto ekuivalente e prodhimit per njesi gjate muajit te fundit eshte 10 EUR/njesi. Kompania perdor metoden FIFO per vleresimin dhe shperndarjen e kostove. Kosto totale e 2,000 njesive te prodhuara dhe transferuara ne magazine e produkteve te gatshme gjate muajit mars ka qene:

- a. 18,210 EUR
- b. 19,910 EUR
- c. 20,000 EUR
- d. 20,510 EUR
- e. 21,710 EUR
- f. 22,500 EUR
- g. 24,000 EUR
- h. 24,710 EUR

Përgjigja e saktë është alternativa B

8. Është faktor motivimi sipas teorisë së dy faktorëve e Herzberg:

- a. marrëdhëniet ndërpersonale
- b. paga
- c. mbikqyrja
- d. politika e kompanisë
- e. njohja
- f. kushtet e punës
- g. siguria e punës
- h. administrimi

Përgjigja e saktë është alternativa E

9. Është karakteristikë e sistemit mekanik në strukturimin organizativ të një biznesi:

- a. përkushtim ndaj detyrës
- b. koordinim me strukturë rrjet
- c. principi i organizimit me integrim
- d. formalizëm i ulët
- e. përkushtimi tek e gjithë organizata
- f. komunikimi është vertikal
- g. derivon nga ekspertiza nga mjediset jashtë firmës
- h. njohuritë të shpërndara në gjithë organizatën

Përgjigja e saktë është alternativa F

10. Nga të mëposhtmet, është zëvendësues i sjelljes së leadershipit (udhëheqjes):

- a. indiferentizimi i punonjësve ndaj shpërblimeve
- b. mungesa e fleksibilitetit
- c. formalizmi i lartë
- d. veçimi i liderit nga vartësit
- e. pushteti i vogël i pozitës
- f. fleksibiliteti i ulët
- g. valenca e ulët e punonjësve ndaj pagesave të bëra
- h. puna rutinë

Përgjigja e saktë është alternativa H

PYETJE ME SHTJELLIM (4 pikë secila pyetje)

1. Ju jeni partner ne nje firme auditimi. Eshte ngritur ceshtja e meposhtme:

Klienti juaj me marredhenie me te gjate, me te cilin ju keni mbi 15 vite qe jeni i angazhuar si partner angazhimi, ju ka ftuar ne nje udhetim te gjate luksoz.

Komentoni ne ceshjet etike dhe ceshtje te tjera profesionale te ngritura nga ceshtja me siper, duke shpjeguar rreziqet, rendesine e rreziqeve dhe cdo faktor tjeter qe do te merrni ne konsiderate, duke perfshire edhe masat e marra per uljen/eliminimin e rrezikut.

Zgjidhje:

Rreziku qe shfaqet ne rastin me siper eshte rreziku i familjaritetit per shkak te angazhimit te gjate dhe marredhenies personale me klientin. Ky rrezik perforcet edhe me shume nga pranimi i nje mikepritje te tepruar/ luksoze, ne nivel personal.

Faktoret per tu marre ne konsiderate per te analizuar rendesine e rrezikut jane:

- Angazhimi me klientin eshte nje angazhim auditimi
- Klienti nuk eshte njesi me interes publik
- Angazhimi me klientin per me shume se 15 vite dhe marredhenia personale me klientin

Rreziku ne ceshtjen me siper eshte i larte, por marre parasysh qe klienti nuk eshte me interes publik duke qene se ne ushtrim nuk shprehet qe klienti eshte njesi me interes publik, ky rrezik nuk eshte i pakapercyeshem. Per kete arsye duhet te merren masa mbrojtese per te ulur rrezikun. Kjo mund te behet pershembull duke angazhuar nje partner te dyte per te bere nje rishikim para leshimit te raportit te auditimit te klientit dhe duke konsideruar per te bere rotacion nga auditimi i klientit per nje periudhe kohe duke bere keshtu qe partneri i angazhimit te jete dikush tjeter. Gjithashtu nuk duhet marre me mikepritje nga drejtuesit e klientit, pervecse nese eshte jo material.

2. Përshkruani termin bazë të dhënash. Nga ndryshon ai nga sistemi i menaxhimit të bazave të të dhënave?

Zgjidhje:

Baza e të dhënave është një bashkësi të dhënash të organizuara që i shërbejnë aplikimeve të ndryshme duke centralizuar të dhënat dhe minimizuar të dhënat e tepërta. Ndërsa sistemi i menaxhimit të bazave të të dhënave (DBMS) është softëare special që krijon dhe mirëmban bazën e të dhënave dhe lejon aplikime biznesi të nxjerrin të dhëna pa pasur nevojën e krijimit të skedarëve të vecantë në programet e tyre kompjuterikë.

3. Cilat janë shkurtimisht funksionet kryesore të një sistemi operativ? Përshkruani gjerësisht një nga funksionet.

Zgjidhje:

Funksionet kryesore të një sistemi operativ janë:

- Kontrollon funksionet e pergjitheshme te harduereve kompjuterik
- Ofron nje 'user interface' dhe menaxhim te I/O
- Ofron nje shkalle pavaresi harduerike
- Manaxhon memorien e sistemit
- Manaxhon detyrat e perpunimit
- Ofron mundesine e lidhjes ne rrjet
- Kontrollon aksesin e burimeve te sistemit
- Manaxhon file-t

Sa i takon një funksioni më lartë mund të zgjidhet edhe përshkrimi i tij më gjerësisht.

4. Pse pavaresia e audituesit te jashtem eshta kaq e rendesishme?

Zgjidhje:

Pavaresia e audituesit te jashtem eshte e rendesishme pasi:

- Pronaret dhe palet e tjera te interesuara kane nevojte per nje kendveshtrim te besueshem per administrimin e kompanise nga ana e drejtuesve/administratoreve te saj, ne menyre qe te marrin vendime ne lidhje me kompanine.
- Nje opinion pa rezerva nga nje auditues i jashtem, ne lidhje me llogarite e nje kompanie do ti jap ketyre llogarive me shume kredibilitet dhe do te terheq me shume investitore qe do te duan te investojne ne kompani.
- Nje mungese pavaresie e audituesit te jashtem gjate kryerjes se auditimit, do te thote qe nuk eshte kryer nje auditim efektiv. Per kete arsye pronaret nuk marrin vlere ne lidhje me koston e auditimit.
- Nje mungese pavaresie e audituesit te jashtem gjate kryerjes se auditimit mund te coje ne mospermbushje te kerkesave profesionale. Mospermbushja e ketyre kerkesave mund te ul kredibilitetin e profesionit te audituesit dhe standardeve qe ata zbatojne.

5. Jepni përkufizimin e “Transparencës” dhe “Drejtësisë” dhe shpjegoni rëndësinë e tyre në sektorin publik.

Zgjidhje:

Të qenit transparent do të thotë të qenit i hapur dhe dhenie e qartë e informacionit relevant për grupet e interesit dhe gjithashtu mosfshehja e informacionit që mund të ndikojë vendimet e grupeve të interesit. Informacioni i dhënë duhet të përmbajë detaje të mjaftueshme për të përmbushur pritshmëritë e grupeve të interesit.

Drejtësia është gjithashtu një temë kryesore në sektorin publik. Të jesh i drejtë do të thotë të njohësh interesat e shumta dhe ti vlerësosh ato kundër të tjerëve në një mënyrë të barabartë dhe transparente.

Sektori publik i detyrohet shumë publikut të gjerë dhe duhet të jetë i drejtë dhe transparent për të gjithë palët. Për shkak se sektori publik vepron duke përdorur paratë e taksapaguesve, duhet që jo vetëm të jetë i drejtë dhe transparent por edhe të shihet si i tillë, në zbatimin e politikave kombëtare dhe lokale. Jo gjithmonë të gjithë qytetarët dhe problemet trajtohen në mënyrë të barabartë, meqëse disa interesa duhet të nënvlerësohen për përfitimin më të gjerë të

shoqërisë, por sektorit publik i duhet të shpjegojë çfarëdo mënyre që përdor për të balancuar interesat e ndryshme të palëve të interesuara mbi të cilat ky sektor ka ndikim.

6. Në bazë të kërkesave të SNA 315 “Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij”, audituesi duhet të identifikojë dhe vlerësojë rreziqet e anomalisë materiale për të siguruar një bazë për projektimin dhe kryerjen e procedurave të mëtijshme të auditimit.

Kërkohet:

- a. Përmendmi **katër** hapat që duhet të ndjekë audituesi për identifikimi dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale sipas SNA 315.
- b. Përmendni shkurtimisht **katër** shembuj të kushteve dhe ngjarjeve që mund të tregojnë ekzistencën e rreziqeve të anomalisë materiale sipas përcaktimeve të SNA 315.

Zgjidhje:

- a. Sipas SNA 315, audituesi duhet të identifikojë dhe vlerësojë rreziqet e anomalisë materiale në nivel të pasqyrave financiare; dhe në nivel pohimi për klasat e transaksioneve, tepricat e llogarive dhe shënimet shpjeguese. SNA 315 kërkon nga audituesi që të ndjekë ndjekë këto hapa:
 - i. **Të identifikojë rreziqet** gjatë procesit të njohjes së entitetit dhe të mjedisit të tij, përfshirë kontrollet e brendshme përkatëse që lidhen me rreziqet;
 - ii. **Të çmojë rreziqet e identifikuar** dhe të vlerësojë nëse këto rreziqe **janë të përhapura në pasqyrat financiare si një e tërë** dhe potencialisht ndikojnë në shumë pohime;
 - iii. **Të krijojë lidhjen midis rreziqeve të identifikuar** dhe asaj ç’ka mund të jetë gabim **në nivel pohimi**, duke marrë në konsideratë kontrollet e brendshme të përshtatshme që audituesi synon të testojë; dhe
 - iv. **Të vlerësojë mundësinë e ndodhjes së anomalive**, përfshirë mundësinë e anomalive të shumëfishta, **dhe nëse këto anomali të mundshme janë të një madhësie të tillë që mund të çojnë në anomali materiale.**
- b. Shembuj të kushteve dhe ngjarjeve që mund të tregojnë ekzistencën e rreziqeve të anomalisë materiale përfshijnë:
 - Operacionet realizohen në rajone që janë ekonomikisht jo të qëndrueshme;
 - Zgjerimi në rajone të reja;
 - Çështjet e vijimësisë dhe të likuiditetit;
 - Transaksione të rëndësishme me palët e lidhura.

Shtojca 2 e SNA 315 prezanton një listë të gjerë të shembujve të kushteve dhe ngjarjeve që mund të tregojnë ekzistencën e rreziqeve të anomalisë materiale.

7. Cfare faktoresh duhet te kete parasysh nje njesie ekonomike, para se te vendose qe te ndryshoje metoden e shperndarjes se kostove te pergjitheshme (prsh, nga metoda tradicionale ne metoden ABC).

Zgjidhje:

Tradicionalisht, shperndarja e shpenzimeve te pergjithshme te lidhura te prodhimit, eshte pare me shume si nje proces “mekanik” me qellim llogaritjen e koston per njesi, sesa nje proces me qellime vendimarrje. Por rritja e interesit per manaxhuar dhe kontrolluar me mire keto kosto, ka rritur rendesine e vendimarrjes se njesive ekonomike ne lidhje me metoden e zgjedhur per ti shperndare shpenzimet e pergjithshme te prodhimit.

Disa nga faktoret kryesore qe mund te ndikojne tek nje njesi ekonomike ne vendimin e saj per zgjedhjen apo ndryshimin e metodes se shperndarjes se kostove te pergjitheshme te prodhimit jane si me poshte:

- Natyren e produkteve apo sherbimeve qe ajo ofron;
 - Kompleksiteti i proceseve te prodhimit dhe i aktiviteteve ne teresi qe zhvillon njesia ekonomike;
 - Perfituesmeria ekonomike qe sjell ndryshimi i metodes se koston (analiza kosto perfitim);
 - Sistemet e informacionit dhe sistemet kontabel qe disponon njesia ekonomike dhe nese keto sisteme jane ne gjendje te sigurojne informacionin e nevojshem per nje metode te caktuar. Prsh. informacionin qe kerkohet per metoden ABC.
 - Natyren dhe shumen e shpenzimeve te pergjithshme te prodhimit qe duhet te shperndahen;
 - Kufizimet ligjore dhe kontabel ne lidhje me aplikimin e nje metode te caktuar kostoje;
 - Impakti qe pritet te kete ndryshimi i metodes se koston tek punonjesit puna e te cileve eshte e lidhur me keto kosto.
8. Cfare kuptoni me *stil konsultativ* te udheheqjes? C’kuptoni me *zevendesues* te udheheqjes, si dhe tregoni 4 zëvendësues të udhëheqjes (lidërshipt) sipas stilit të lidershiptit të orientuar nga detyra dhe nga njerezit.

Zgjidhje:

Stili konsultativ i udhëheqjes është ai stil lidershipi që përdoret nga menaxherët të cilët kanë besim tek vartësit, por ky besim nuk është i plotë. Menaxherët praktikojnë një mbikqyrje relativisht të gjerë, pra jo të fortë. Bazohet në motivimin e njerëzve me anën e shpërblimeve e duke përdorur në një masë të vogël dënimet. Në majën e piramidës merren vendimet më të rëndësishme dhe delegohet në nivelet më të ulëta pjesa tjetër e vendimeve. Stili konsultativ është stili që krijon shkëputjen finale nga stili shfrytëzues-autokratik dhe dashamirës-autokratik.

Zevendesuesit e udhëheqjes jane ata faktore situacionale qe e bejne sjelljen e lidershiptit te panevojshme.

Zëvendësuesit e udhëheqjes (lidërshipt) sipas stilit të lidershiptit të orientuar nga detyra dhe nga njerezit jepen ne tabelen vijuese:

	<i>Faktoret situacionale</i>	<i>Orientimi nga detyra</i>	<i>Orientimi nga njerezit</i>
ZEVENDESUES	Eksperienca, aftesite, trajnimi i punonjesve	+	
	Puna e strukturuar e rutine	+	
	Feedback nga puna me strukturim te larte	+	
	<i>Orientimi profesional i punonjesve</i>		+
	<i>Punet qe ofrojne kenaqesi te brendshme</i>		+

9. Perkufizo çfarë kupton me sistem të kontrollit të brendshëm? **(2 pike)**. Cilat janë objektivat e nje njësie ekonomike mbi të cilat adresohet sistemi i kontrollit të brendshem? **(2 pikë)**

Zgjidhje:

Sistemi i kontrollit të brëndshëm është një sistem i krijuar, i zbatuar dhe qe vihet ne funksion nga personat e ngarkuar me qeverisjen, bordi i drejtorëve, drejtimi ekzekutiv dhe personel tjetër i një njësie ekonomike për të arritur siguri të arsyeshme mbi plotësimin e objektivave të njësisë ekonomike. Një sistem kontrolli i brendshëm permban një sistem të tërë kontrollesh financiare dhe jo-financiare të vendosura nga drejtuesit me synim që të sigurohet vazhdimësia e funksionimit të njësie ekonomike në mënyrë efektive dhe të rregullt dhe se janë zbatuar objektivat dhe politikat e drejtimit.

Objektivat e nje njësie ekonomike mbi të cilat adresohet sistemi i kontrollit të brendshëm listohen si me poshtë vijon:

- 1- Raportim financiar i besueshëm dhe i vërtetë*
- 2- Efektivitet dhe eficencë operacionesh*
- 3- Përputhshmëri me rregullat dhe ligjet përkatëse*
- 4- Ruajtje dhe siguri ndaj veprimeve të pautorizuara dhe përvetësimit të padrejtë të aktiveve*

10. Tregoni metodat e rekrutimit të punonjësve në organizatë; avantazhet dhe disavantazhet e secilës mënyrë rekrutimi. Cilat mënyra sugjeroni në rastin e bizneseve të ndryshme në Shqipëri?

Zgjidhje:

Metodat e rekrutimit të punonjësve janë **të brendshme** dhe **të jashtme**:

a- Burimet e brendshme të rekrutimit

Avantazhet:

- Duke qenë se departamenti i burimeve njerëzore mban dokumentacionin përkatës për çdo punonjës, ku jepen në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat e tyre si kualifikimi, niveli dhe lloji i arsimit, stazhi në punë, etj, informacioni i marrë është i besueshëm dhe i saktë.
- Përdorimi i punonjësve të brendshëm për zënien e vendeve vakantë është një mënyrë rekrutimi me shpenzime të ulëta.
- Kandidatët e brendshëm e njohin mirë organizatën dhe parimet themelore mbi të cilat bazohet funksionimi i saj; pra ata nuk duan kohë të veçantë për tu ambientuar në organizatën e tyre.
- Ndjekja e kësaj politike shërben si nxitje tek njerëzit të punojnë më shumë e më mirë për të bërë karrierë në fushën e tyre profesionale.

Disavantazhet:

- Megjithëse kostoja e rekrutimit është e ulët, shpenzimet e trajnimit mund të jenë të larta.
- Mund të ekzistojnë vështirësi për të zëvendësuar me efektivitet punonjësit të cilët do të lëvizin nëpër vende të tjera pune.

b- Burimet e jashtme të rekrutimit

Orientimi drejt burimeve të jashtme preferohet kur:

- Disavantazhet e rekrutimit të brendshëm janë më të mëdha sesa përfitimet e tij.
- Kandidatët e brendshëm nuk i plotësojnë kushtet për të zënë vendet e lira apo kur kualifikimi i personave të jashtëm është më i lartë.
- Organizata dëshiron të tërheqë brenda radhëve të saj njerëz të rinj e me ide të reja.
- Sido që të jetë organizata, do të kërkojë njerëz të tjerë kur ajo do të zgjerojë aktivitetin e saj, dhe për këtë do t'i duhen punonjës shtesë për vendet e reja të punës.

Disavantazhet:

- Kostoja relativisht e lartë e rekrutimit.
- Mundësia e përcaktimit të një zgjidhjeje jo të përshtatshme, si dhe prania e një kohe të caktuar për tu adaptuar me organizatën e re.

Lidhur me metodat e rekrutimit për tu ndjekur nga bizneset shqiptare, mund të thuhet që duhet *e kombinuar & sipas rastit*, dhe varet nga faktorë të tillë si madhësia e kompanisë, buxheti, specifikat e vendit të punës, numri i punonjësve dhe kualifikimi i tyre, politikat e kompanisë, strategjia e kompanisë, etj, por duke parë avantazhet dhe disavantazhet e secilës metode, sugjerohet që për punë për të cilat ekziston ekspertizë nga punonjësit brenda organizatës, e mira është që të përdoret fillimisht rekrutim i brendshëm ... në pamundësi të kalohet tek rekrutimi i jashtëm; kurse për punë të niveleve të larta apo që kërkohej ekspertizë specifike, mund të kalohet direkt tek rekrutimi i jashtëm.

USHTRIME (5 pikë secili ushtrim)

Ushtrimi 1

Target është një rrjet hipermarketesh dhe supermarketesh me shumë dege dhe pika të shpërndara kudo në SHBA dhe vendet e tjera perendimore. Target ka zhvilluar një sërë metodash analitike për të parashikuar preferencat e klienteve të saj për produkte. Një mjet për analizën e informacionit që përfshin zbulimin automatik të modeleve dhe marrëdhënieve në një data warehouse quhet _____. (Të shpjegohet më gjerësisht koncepti).

Zgjidhje:

Data mining- një mjet për analizën e informacionit që përfshin zbulimin automatik të karakteristikave dhe marrëdhënieve në një data warehouse; ofron analizën bottom-up, discovery-driven.

Ushtrimi 2

Pershkruani dhe keshilloni në tiparet karakteristike të skemave të bonusit që mund të hartohen për të motivuar drejtoret jo-ekzekutiv, të cilët punojnë me kohë të pjesshme dhe paguhet me tarifa sipas kontratave për një numër të caktuar vitesh dhe të cilëve u kërkohej nga kodi i qeverisjes së korporatave të ruajnë pavaresinë.

Zgjidhje:

Tiparet e skemave të bonusit për të motivuar drejtoret jo-ekzekutiv duhet të kenë parasysh:

- Duhet të sigurojnë që drejtoret jo-ekzekutiv që rekrutohen të jenë të cilësive të larta dhe të motivuar, duke siguruar kështu që pronaret do të përfitojnë nga emerimi i tyre.
- Bonusi mund të paguhet në vlerë monetare ose aksione/pjesë të shoqërisë.
- Skema e bonusit mund të lidhet me performancën afatgjatë të shoqërisë sesa thjesht me performancën e një viti.
- Skema e bonusit duhet të hartohet në mënyrë të tillë që të japë stimulim për drejtuesit jo-ekzekutiv për të arritur objektiva të caktuara.
- Çdo skemë bonusi e orientuar drejt një qëllimi duhet të paguhet menjëherë me arritjen e qëllimit të caktuar.

Ushtrimi 3

Cilat janë komponentet në të cilat bazohet kuadri i menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjeve të COSO? Sipas mendimit tuaj, cilat janë disa nga kritikët që mund të bëhen kuadrit COSO?

Zgjidhje:

Komponentet në të cilat bazohet kuadri i menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjeve të COSO janë:

- Ambjenti i kontrollit
- Vlerësimi i rrezikut

- Aktivitetet e kontrollit
- Komunikimi dhe informacioni
- Aktivitetet e monitorimit

Disa nga kritikat që mund të behen kuadrit COSO janë:

- Fokus i brendshëm
Duket sikur COSO fillon në vendin e gabuar, me ambjentin e brendshëm dhe jo të jashtëm, duke mos reflektuar në këto mënyra në mënyra të mjaftueshme impaktin e ambjentit konkurrues, rregullatoreve dhe paleve të tjera të interesuara.
- Identifikimi i rrezikut
Rreziqet identifikohen kryesisht në kuader të ngjarjeve, vecanërisht të ngjarjeve të papritura me pasoja të mëdha, duke anashkaluar në këto mënyra ndryshimet e ngadalta që mund të rritin rrezikun si për shembull ndryshimi i kultures së brendshme.
- Vlerësimi i rrezikut
Mund të thuhet që inkurajohet një metode e tej të thjeshtezuar në vlerësimin e rrezikut, duke menduar në një pasoje të vetëm si pasoje e materializimit të rrezikut. Shumë rreziqe mund të kenë disa pasoja.
- Palet e interesuara
COSO nuk merr parasysh influencën e paleve të interesuara, edhe pse shumë rreziqe që korporata mund të hasë janë si pasoje e konfliktit midis objektivave të korporatës dhe të paleve të interesuara.

Ushtrimi 4

Shpjegoni përmbajtjen tipike të një raporti për qeverisjen e korporatave të praktikës më të mirë në kuader të një raporti vjetor.

Zgjidhje:

- Detaje për bordin e drejtoreve
Pronaret do të jenë të interesuar për tu informuar se si funksionon bordi si një organ kolegjial për marrjen e vendimeve dhe monitorimin. Raporti duhet të përmbajë detaje në lidhje me mbledhjet e bordit si frekuenca e mbledhjeve, pjesëmarrje, vlerësimi i performancës etj.
- Drejtuesit jo-ekzekutiv dhe komitetet
Pronaret do të kërkojnë evidenca që drejtuesit jo-ekzekutiv janë objektiv dhe kanë autoritet, duke kërkuar për evidenca në lidhje me pavaresinë. Duke qenë se drejtuesit jo-ekzekutiv do të jenë pjesë e komiteteve të ndryshme, raporti duhet të përshkruajë detaje për termat e referencës dhe përberjes së këtyre komiteteve si dhe frekuencën e mbledhjeve.
- Llogaritë dhe auditimi
Raporti vjetor duhet të përmbajë shpallje specifike për shërbimin e sigurisë, duke përfshirë përgjegjësinë që kanë drejtuesit e shoqërisë në përgatitjen e pasqyrave

financiare dhe vijimesine. Duhet te jepet informacion ne lidhje me marredheniet me audituesit, duke perfshire arsyet e ndryshimit te audituesit dhe hapat e ndermarra per tu siguruar qe audituesit jane objektiv dhe te pavarur. Nese shoqeria nuk ka nje njesi auditimi te brendshem, raporti duhet te shpjegoje pse.

- **Komunikimi me pronaret**
Raporti vjetor duhet te perfshije informacion ne lidhje me marredheniet me pronaret dhe rruget e komunikimit qe jane ndjekur.

Ushtrimi 5

Ju jeni auditues i lartë për auditimin e Chrome Shpk, një shoqëri që merret me nxjerrjen dhe përpunimin e kromit, dhe jeni duke vlerësuar sistemet e brendshme të kontrollit të klientit për shpenzimet e pagës, sigurimet shoqërore dhe shëndetsore si dhe kompensimet e punonjësve. Fabrika e përpunimit të kromit është në gjendje pune 24 orë në ditë, 7 ditë në javë; ndërkohë që puna e personelit është e organizuar në turne 8-orarëshe. Punonjësit e fabrikës paguhet për çdo orë të punuar mbi bazën e një pagese orare. Përlllogaritja e orëve të punës është e automatizuar dhe kjo realizohet përmes një sistemi me kartë; ku çdo punonjës është i pajisur me një kartë me numër rendor unik dhe emrin e punonjësit mbi të. Punonjësi është i detyruar të kalojë kartën në një pajisje të vendosur në hyrje dhe dalje të fabrikës në mënyrë që të gjurmohet ora e hyrjes dhe daljes nga fabrika dhe ky proces monitorohet nga një staf i dedikuar që vendoset pranë pajisjes në momentin e fillimit dhe mbylljes së turnit. Të dhënat e orëve të punës janë automatikisht të transferuara në sistemin e përlllogaritjes së pagës, i cili bën automatikisht përlllogaritjen e pagës së pagueshme ndaj punonjësit si dhe ndalesat përkatëse të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore. Supervizori i burimeve njerëzore kontrollon periodikisht mbi një popullatë rastësore që përlllogaritjet janë të sakta dhe sistemi punon në mënyrë efektive.

Chrome Shpk ka një department të brendshëm të burimeve njerëzore që kryen me rigorozitet procedurat e punësimit të punonjësve të ri apo largimit të tyre. Ndonjëherë punonjësve i kërkohet të punojnë jashtë orarit, zakonisht për të zëvendësuar kolegët të cilët mund të jenë me leje. Raportet e orëve jashtë orarit përgatiten cdo 3-mujor nga departamenti i burimeve njerëzore dhe i dërgohen për rishikim dhe aprovim supervizorëve përkatës të fabrikës. Pagesa për orët jashtë orarit paguhet cdo fund muaji, së bashku me pagën. Paga e pagueshme përlllogaritet nga specialisti i financës dhe dërgohet për aprovim tek drejtuesja e financës, e cila, përpara autorizimit kontrollon gjithë listëpagesën.

Kërkohet:

Identifikoni dhe shpjegoni shkurtimisht **pesë** kontrole të brendshme të hartuara dhe zbatuara nga Chrome Shpk lidhur me shpenzimet e pagës dhe kompensimet e punonjësve.

Zgjidhje:

Kontrollet e brendshme në sistemin e pagave të Chrome Shpk janë si më poshtë:

- i. **Gjurmimi dhe rregjistrimi i automatizuar i orëve të punës përmes sistemit të kartës së aksesit.** Punonjësve të fabrikës u lëshohet një kartë individuale me numër rendor unik dhe emrin e punonjësit. Kjo duhet të sigurojë që punonjësit paguhet

vetëm orët që kanë punuar. Kontrolli i brendshëm përforëcohet nga fakti që një person qëndron në vendin e pajisjes së regjistrimit të kartës për t'u siguruar që cdo punonjës kalon vetëm kartën e tij.

- ii. **Automatizimi i sistemit të llogaritjes së pagës përmes lidhjes automatike mes sistemit të gjurmimit të orëve të punës dhe transferimit të të dhënave nga ky i fundit tek sistemi i automatizuar i përlllogaritjes së pagave.** Sistemi i pagave automatikisht llogarit pagën bruto (si total i orëve të punuara të përlllogaritur në mënyrë sistematike) dhe neto së bashku me zbritjet e detyrueshme për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore. Automatizimi i procesit përbën një kontroll të shtuar dhe zvogëlon rrezikun e ndodhjes së gabimeve. Nëse ky proces do të ishte manual, sidomos në kushtet e punës 24/7 dhe me një numër të madh punonjësish, mundëisa e gabimeve mund të ishte më e lartë.
- iii. Një popullatë e llogaritjeve të bëra nga sistemi i automatizuar i pagës **ri-kontrollohet nga supervizori i pagave/ burimeve njerëzore** për të siguruar që sistemi po funksionon në mënyrë efektive; dhe kjo teston kontrollin e automatizuar brenda sistemit.
- iv. Chrome Shpk ka një departament të burimeve njerëzore i cili është përgjegjës për punonjësit e rinj dhe ata që largohen dhe përgatiten me rigorizitet të dosjeve përkatëse. Duke pasur një **ndarje të detyrave midis stafit të burimeve njerëzore dhe departamentit të financës** që merret me procesimin e pagave, zvogëlohet rreziku i vendosjes në listëpagesë së punonjësve fiktivë dhe gjithashtu pagesës së punonjësve që nuk janë pjesë e shoqërisë.
- v. Listëpagesa **rishikohet në detaje dhe dakordësohet nga ana e drejtueses së financës** para se të autorizohet pagesa bankare. Kjo zvogëlon rrezikun e kryerjes së pagesave mashtruese përmes krijimit të punonjësve fiktivë dhe punonjësit e tjerë që janë hequr nga listëpagesa.

Ushtrimi 6

Ju jeni manaxher auditimi pranë Partners Shpk dhe jeni përgjegjës për auditimin e TransportAlb Shpk. Ky është viti i dytë që klienti auditohet nga Partners Shpk. Shoqëria operon në sektorin e logjistikës dhe manaxhimit të zinxhirit të furnizimit duke ofruar për klientët e saj shërbime të distribucionit dhe magazinimit. Ju keni zhvilluar tashmë një takim me E.K., Drejtuesen e Financës së TransportAlb Shpk, e cila ju ka vënë në dispozicion pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 si dhe lëvizjet në llogaritë kontabël të ekstraktuara nga sistemi financiar i shoqërisë. Ditën e hënë, ju keni një mbledhje me grupin e auditimit, pjesë e të cilit është dhe një auditues i ri, i cili po e pret me shumë entuziazëm auditimin e tij të parë.

Kërkohet:

Shpjegoni grupit të auditimit dhe veçanërisht anëtarit të ri, përse procedurat analitike kryhen në fazën e planifikimit të auditimit si pjesë themelore e vlerësimit të rrezikut. Në shpjegimin

tuaj duhet të mbani parasysh kërkesat e SNA 315 Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij.

Zgjidhje:

SNA 315 kërkon që audituesi të kryejë procedura analitike në fazën e planifikimit të auditimit për **identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale**. Kjo mund të jetë në nivel të pasqyrave financiare si e tërë dhe në nivel të pohimit.

Procedurat mund të zbulojnë **aspekte të entitetit apo shenja për një transaksion ose ngjarje për të cilën nuk ka qenë i njohur më parë**, prandaj e shtyn auditorin të hetojë me tej çështjen me të tjera procedura në kombinim me testime të tjera si testimet e efikasitetit të kontrolleve të brendshme apo testimet thelbësore.

Procedurat analitike mund të ndihmojnë në **identifikimin e ekzistencës së transksioneve ose ngjarjeve të pazakonta** që mund të sjellin rreziqe të anomalisë materiale, **veçanërisht rreziqeve të anomalisë materiale për shkak të mashtrimit**.

Procedurat analitike ndihmojnë audituesin në hartimin dhe kryerjen e **procedurave të auditimit**, për të për të planifikuar **natyrën, afatet dhe shtrirjen e procedurave të mëtjeshme të auditimit** dhe përgatitjen e **strategjisë dhe planit të auditimit**.

Pa kryer procedurat analitike, audituesi mund të mos jetë në gjendje të identifikojë të gjithë rreziqet e anomalisë materiale dhe të përgjigjet përmes procedurave të mëtjeshme. Kjo do të rriste **rrezikun e mos-zbulimit**, duke çuar në lëshimin e një **opinionit të papërshtatshëm të auditimit**.

Ushtrimi 7

Dy produkte G dhe H prodhohen gjatë një procesi të përbashkët prodhimi. Produkti G mund të shitet menjëherë pas fazës së ndarjes nga H. Ndërsa produkti H për qëllime shitje, duhet të përpunohet me tej si një produkt HH. Nuk ka gjendje inventari në fillim dhe as prodhimi në proces për produktet G, H dhe HH.

	EUR
Kosto të përbashkëta prodhimi	350,000
Kosto të mëtjeshme përpunimi të produktit H	66,000

Produkti	Njesi të prodhuara	Njesi në fund të periudhës
G	420,000	20,000
HH	330,000	30,000

Kerkohe: Duke përdorur si metode për shpërndarjen e kostove të përbashkëta metoden e sasive fizike, gjeneroni cila është vlera e kostot së produktit HH gjendje në fund të periudhës.

Zgjidhje:

Si fillim gjejmë kostot e përbashkëta të prodhimit që i përkasin produktit H i cili do të përpunohet me tej në produktin HH. Shpërndarja e kostos do të bëhet në bazë të njësive të prodhuara. Pra,

duke marre ne konsiderate raportin e njësive H te prodhuara kundrejt njësive totale te prodhuara bashke me G.

Kostot e përbashkëta për H= $((330,000/(420,000 + 330,000)) \times 350,000 = \$154,000$. Kjo është kosto e produktit H ne momentin qe ndahet nga procesi i prodhimit te përbashkët me produktin G.

Pas ndarjes nga G, kësaj kostoje do ti shtohen edhe 66,000 \$ kosto për tu prodhuar produkti HH.

Prandaj, kosto mesatare e prodhimit për një njësi HH do ishte= $(154,000 \$ + 66,000 \$)/330,000$ njësi = 0.67 \$/njësi.

Vlera e inventarit gjendje te produktit HH ne fund te periudhës = $30,000$ njësi $\times 0.67 \$ = 20,100 \$$ (afërsisht 20,000 \$).

Ushtrimi 8

Cfarë lloj qëndrimi i punonjësve do të ndihmonte ose pengonte një rishikim efektiv të kontrollit të brendshëm?

Zgjidhje:

Qendrimet e meposhtme mund te ndihmojne ose pengojne rishikimin efektiv te kontrollit te brendshem:

- Reagimi ndaj sjelljes se drejtimit
Punonjesit kane tendencen qe ti marrin kontrollet me te njejtin seriozitet qe i merr edhe drejtimi. Ata do te kene parasysh se me sa seriozitet aplikohen kontrollet nga drejtuesit e larte, nese drejtuesit i larte i anashkalojne kontrollet etj.
- Pranueshmeria e kontrolleve
Nese punonjesit do te shohin qe kontrollet jane joreal/ te paarritshme, ata nuk do ti marrin rishikimet e kontrollit nga ana e drejtimit me seriozitet
- Bashkepunimi i punonjesve
Nese punonjesit do te bashkepunojne, evidencat per drejtimin mund te manipulohen, jo domosdoshmerisht duke shkaktuar mashtrim nga ana e punonjesve, por edhe ndarja e qellimeve te njejta per te shmangur burokraci te panevojshme.
- Fokusi ne kontrolle te caktuara
Nese theksi do te vihet ne kontrolle te caktuara, do ti kushtohet me pak rendesi kontrolleve te tjera, te cilat gjithashtu mund te jene te rendesishme.
- Mbeshtetja ne memori
Shume kontrolle mund te varen nga njohurite qe kane ngelur ne mendjen e punonjesve. Kjo mund te coje ne nje mungese te qartesis se nese kontrollet funksionojne apo jo dhe mund te rrit paqendrueshmerine dhe keqkuptimin e kontrolleve.

Ushtrimi 9

Sipas mendimit tuaj, nje model i pergjithshem i kontrollit kibernetik, sa faza? Permendni dhe pershkruani secilen prej tyre.

Zgjidhje:

Nje model i pergjithshem i kontrollit kibernetik ka kryesisht 6 faza:

- Identifikimi i objektivave
Proceset te cilat kontrollohen duhet te kene objektiva pa te cilat kontrollet nuk kane kuptim
- Vendosja e objektivit
Nje objektiv apo parashikim i procesit qe kontrollohet eshte i domosdoshem ne menyre qe drejtuesit te verifikojne nese objektiva po arrihen apo jo.
- Matja e rezultatit
Rezultati i procesit duhet te jete i matshem
- Krahاسimi i arritjeve me objektivat
Duke marre ne kete menyre feedback
- Identifikimi i veprimeve korrigjuese
Kjo per te bere te mundur qe gabimet te reduktohen ose eliminohen
- Implementimi i veprimeve korrigjuese
Te tilla si ndryshimi i objektivave, rimodelimi i procesit etj.

Ushtrimi 10

Politikat e shtetit A po inkurajojne investimet e hotelve luksoze ne vendin e tyre. Hoteli AB është një hotel lokal/ kombëtar dhe zotërohet 100% nga një familje vendase. Administrimi i hotelit kryhet nga palë të treta, që nuk janë pronar. Performanca e hotelit ka qënë e kënaqshme dhe personat përgjegjës për drejtimin e hotelit përfitojnë bonus në varësi të performancës vjetore të hotelit. Niveli i pagave në vendin A është i ulët dhe punonjësit kryesisht janë paguar me paga afër limitit minimal, në mënyrë që të maksimizohen fitimet dhe personat përgjegjës për drejtimin të përfitojnë bonuset. Për shkak të nivelit të ulët të pagave, hoteli ka patur lëvizje të shumta të stafit. Politika e vendit A ka premtuar për të rritur pagat dhe për të përmirësuar legjislacionin e punës në përgjithësi, duke i ndaluar shoqëritë që të vendosin kushte të pafavorshme punë për punonjësit e tyre. Së fundmi, një prej hoteleve luksoze ka shprehur interesin për të investuar në vendin A dhe kanë kryer disa bisedime me zotëruesit e hotelit AB për të blerë hotelin. Ky investitor ka një kërkueshmëri të lartë ndaj punonjësve të tyre duke vendosur objektiva të larta për tu arritur për punonjësit e vet. Ligji vendas nuk i mbron punonjësit në rast të shitjes së biznesit dhe kontratat e tyre mund të ndërpriten duke favorizuar punëdhënsin. Sindikatat e punonjësve edhe pse janë të formuara, nuk kanë praktikë të ushtrimit të kompetencave të tyre dhe janë të tërhequra nga misioni i krijimit të tyre.

Duke përdorur matricen Mendeloë, analizoni rëndësinë e grupeve të interesit më poshtë, në lidhje me vendimin për të ndryshuar kushtet e punësimit pas shitjes së hotelit AB tek hoteli luksoz që ka shprehur interes për blerje.

a- Personat e ngarkuar me qeverisjen e hotelit AB- 1.25 pikë

b- Pronarëve të hotelit AB- 1.25 pikë

c- Punonjësve- 1.25 pikë

d- Sindikatave të punonjësve- 1.25 pikë

Zgjidhje:

Personat e ngarkuar me qeverisjen

Fuqia e tyre është e ulët, duke qenë se legjislacioni i ri e limiton lirinë e drejtuesve për të ulur koston e punës duke ndryshuar termat kontraktual.

Interesi është i lartë, pasi vendimi për tu marrë është vendim madhor i nderthurur me planet e drejtuesve për të ardhmen e hotelit. Gjithashtu vendimi mund të ketë impakt në shperblimin e drejtuesve.

Pronaret e hotelit

Fuqia është e lartë, pasi pronaret janë në një pozicion të tillë që mund të shesin aksionet e tyre nëse do të marrin një ofertë të mirë. Nëse ata do të marrin ofertë të mirë, sindikatat e punonjësve do të përballen me faktin që kompania ndërkombëtare do të mund të ndjek një qasje shtrenguese

Interesi është i ulët, pasi asnjë nga pronaret nuk është aktivizuar në drejtimin dhe vendimmarrjen e hotelit. Shqetësimi i tyre i vetëm është marrja e dividendit ose realizimi i fitimeve kapitale.

Punonjësit

Fuqia e tyre është e ulët, pasi mund të zëvendësohen lehtësisht

Interesi është i lartë, duke qenë se aftësitë e tyre ekonomike varen nga punësimi

Sindikatat

Fuqia është e lartë pasi kanë fuqinë për të ndermarrë veprime ligjore për të parandaluar hotelin për të ndryshuar termat kontraktual me punonjësit. Interesi është i ulët pasi ata janë të tërhequr nga misioni i tyre.